Milazim KRASNIQI

LULJA E SHPËTIMIT

Poezi

POEZIA MË NDIHMOI QË TË KONSUMOJA ILUZIONET

I nderuari Adnan,
Botimi në këtë vëllim i poezisë sime të plotë, sipas seleksionimit që kam bërë vetë dhe sipas formës përfundimtare që u kam dhënë këtyre poezive, më jep një kënaqësi të veçantë, si kënaqësia që ka secili njeri kur e përfundon një punë të mundimshme e të gjatë.

Poezia ime që botohet në këtë vëllim, është finalizimi i tërë një projekti estetik që kam pasur si poet për më shumë se tridhjetë vjet.

Korrigjimet që kam bërë në shumë poezi, janë rezultat logjik i ndryshimit të koncepteve të mia estetike, fetare dhe jetësore, në udhën e vështirë të kërkimit të së vërtetës dhe të kuptimit të jetës sonë njerëzore.

Tash e di se e kam gjetur udhën e vërtetë, e cila më mundëson vetërealizimin si njeri në këtë botë dhe shpresoj edhe shpëtimin në botën tjetër.
Kërkimi im i gjatë poetik dhe jetësor, shumë herë ka qenë si i përhanshëm, kaotik dhe plot vuajtje, e kjo ka ardhur si pasojë e faktit se nuk e pata zbuluar me kohë të Vërtetën.

I jam mirënjohës poezisë sime, e cila më ndihmoi që të konsumoja iluzionet dhe të gjendesha në një truall, ku zgjedhja në mes të humbjes dhe shpëtimit, nuk ishte më e vështirë.

Dhe më duket se në poezi më nuk kam çka të them.

Kjo është forma përfundimtare e poezisë sime, të cilën do të dëshiroa ta kisha si një lutje të përhershme për veten time dhe për të gjithë njerëzit.

Lutem që edhe fjala poetike të jetë në shërbim të afrimit tonë me Krijuesin tonë.

Vetëm poezia që është e shkruar me idenë që të jetë adhurim ndaj Allahut dhe falënderim ndaj Tij, për të mirat me të cilat na e ka mundësuar dhe zbukuruar ekzistencën në këtë botë, është e denjë që të ribotohet.

Në Prishtinë,
1 nëntor 2004

Me respekt,
Milazim Krasniqi

IMAZHI GRI

KRONIKË
Këto gërmime i bënë
do arkeologë të egër

Të tyret janë shifrat
mbishkrimet
edhe ato që s’thuhen

Thonë kanë thënë të urtët
thonë kanë thënë të marrët

Dikujt duhet zënë besë
Me sytë mes rrënojash,
Kur harron besën e vërtetë

DETI
Det o det det o gjëmë e kaltër
këlthitur nga ëndrrime të mëdha

Të shikoj si fërgëllohesh
dhe njësohem me dallgët e shqetësimeve të tua
që vijnë nga ora qiellore që mat kohën tonë
Mbi kokat tona

Edhe në ty e shoh mrekullinë e krijimit
Të qiejve e të tokës
Dhe të jetës sonë
Të cilës Krijuesi i tha: “Bëhu” dhe ajo u bë
Që t’i jep kuptim mrekullisë
Përmes adhurimit

NATA E QIRAVE
Sonte kanë zbritur në kulmin e shtëpisë
shpirtrat e engjëjt

Ne s’i shohim dot me sy

Sonte kanë ardhur shpirtrat e engjëjt
për të na dashur o gjykuar

Lehtë ia bëjmë me këto të mira në sofër
Po si t’ia bëjmë
me varfërinë e shpirtit

GURI I MEGJËS
Bën po atë gjumë guror
Të shekujve të fjetur

Në faqen e tij të rrahur nga era e shirat
si në një skenë filmi të tmerrit
zgërdhihet nofull’ e vdekjes

Qëndron në një bucë të rëndomtë dheu
Po njerëzit ia bartin peshën në zemër
Që kur humbën paqen në shpirt

DASMË
Ja po vijnë dasmorët po vijnë
shtegmalit e breglumit gjithkah
të gjithë të buzëqeshur

Në oborr është ndezur zjarri
për busull e mirëseardhje
edhe atyre që s'janë të ftuar

Porta është sofër për të gjithë
gëzimi daulle e të gjithëve
një shtëpi kalamaj miq uroni
Dhe dritë në të gjitha anët
Dritë që na shpëton nga humbja
Nëpër udhëkryqet e lumturive
Të rreme

IM ATË
Kur flitet për arat
im atë luan nga vendi

Shikon qiellin
sikur kërkon mendimet në re

Palon duart e çara
si për bekimin e fëmijëve

Në atë dramë të tij
diçka gjithmonë mbetet e paparë
diçka gjithmonë mbetet e pathënë

Kur flitet për arat
në shpirtin e tim eti
Mëshira e të Mëshirshmit
Ringjall besimin
si shiu tokën e vdekur

HIJA E TIM ETI
Dritarja kap një cop qiell
të mugët si fytyrë gruaje me dhembjet e lindjes

Ka kohë që e vështroj këtë sfond të plumbtë
gjelbër të shkyer nga degëmollët
e të qepur etshëm nga pipëtima e gjetheve

Në këtë soditje të qetë
papandehur më shfaqet porteti i tim eti
me atë shqetësimin e përjetshëm
që lidhte tokë e qiej

Dhe m'i shpalon vrragët e duarve e të buzëve
të ashpra e të thella si të tokës
sa unë vërtet s'mund ta di
i mori ai të tokës apo toka të tij

Im atë i mirë im atë i etshëm
ende endet hije arave duke u lutur
për diell shi e bukë
Dhe paqe në shpirt

Tash nga gjethet po bien pikat e para të shiut
të kthjellëta si lot gëzimi
Të dikujt që kthehet përgjithmonë
Nga mërgimi

DITA E TREGUT
Zbresin burrat nga malet
me zemile e thasë
me mushka e kuaj

Qyteti është i tyre këtë ditë
me sheshe me kafene me kënde
pale a ua zë të gjithat që kanë e s'kanë

Në vend e kohë të caktuar
takohen miq e myshterinj
dredhin fjalë e cigare

Dikush shet lopën dikush
blen rrobe për nuset

Kur ia lidhin kërthizën
ditës së tyre të shënuar
marrin udhët kah malet
me veten e tyre për t'u ritakuar

PASDITE ME SHI
Nisën të bien pikat e para të shiut
era i hedh tutje me tërbim

Lagjja ka rënë në një gjumë klinik
rrugët prehen si të sëmurët në komë të thellë

Gjithë pamja që kap syri nëpër xham është
e akullt
si përfytyrimi i hedonistit për vdekjen
Që edhe mund të vdes pa e kuptuar
Se kjo është vërtet mëshira e premtuar

NJËQIND VJET VETMI

Kot po i sjell numrat
thirrjet i përbin nata

Bota ka rënë në gjumë
Ora e murit bën grevë

Ç’të bëj nëse duhen bërë
flijime më të mëdha se vetvetja

Të hesht edhe unë si muret
të kotem me saksitë

Si t’i shpëtoj vetmisë
që më mbulon me harrim

E dhoma që lëngon e bota që fle
të ma bëjnë një vdekje më njerëzore

Ah
Vetmia qenka brendas vetes
Kur humbim lidhjen me Shpërblyesin

Dhe unë qenkam vetë prodhuesi i saj
Si merimanga
kur pa dashje kurthohet në rrjet

ËNDËRR

Përtej muzgut bie briri
në pluhurin e përfytyrimit gjurmë
mamutësh kryqesh avionësh

Gjymtyrët fluturojnë nëpër qiell
duke ndjekur gjahun

E në boshësinë e akullt pastaj
fëmijë epruvetash luajnë me baltë

“prerja e artë” me thikë
pikturon bukurinë e verdhë të murtajës

Dil prej kësaj ëndrre me ngut
Nëpër portën e hapur nga engjëjt

Ajo të rikthen në sprovën fitimtare
Kur me zemër zgjohesh

BALADË TROTUARESH

Me delikatesë bie mbrëmja
siç bie perdja e kadifenjtë
pas një akti të kryer në dramë

Ndanë rrugëve ndizen neonët
në farfurinë e dritave të tyre
Qyteti merr frymë si astmatik

Nëpër markete kafene librari
hyjnë e dalin njerëz
për të marrë a lënë shqetësimet e veta

Në të gjitha anët njerëzit nxitojnë
dhe çuditërisht u ngjajnë pantomistëve
të harruar në rolet e tyre

E gjitha kjo gjalllëri është rrenë e fantazisë
Nëse nata nuk përqafohet në paqe
Si jastëku i butë
Ku pushojnë edhe ëndrrat

METROPOLI

Ku ta hedhësh hapin do të shkelësh
 në gjethe të verdha e fjalë të rreme

Kah ta kthesh kokën do të shohësh
reklama verbuese e fytyra të ngrira

Ç’të zë veshi do të dëgjosh
zhurmë motorësh e rrëfime triviale

Ik kah të ikësh do të shkosh
drejt vdekjes nën rrotat e mitit modern
I cili pikë faji nuk të ka

ANTIPOEZIA

Sot pasdite në shitoren “Gërmia”
kam parë poetin. Më të famshmin poet

Kish të veshur seksi-pallto. Farmerka Texas
e këmishë brilantini. Një minikravatë e
borsalino kauboji. Këmbëzbathur.

Buzëqeshte. Përshëndeste me duart plastike.
Shkëlqente nga dritat shumëngjyrëshe
Të vitrinës

Dhe derisa e shikoja atë të ngrirë
dhe njerëzit kundruall tij të ngrirë
më bëhej se e ndieja të recitonte
një antipoezi pa fund
me zërin joshës të reklamës

IKJE NGA VETJA
Në peizazhin e mëngjesit pranveror
buzëgazi i diellit tjerr ëndrra të arta

Nëpër degët e drunjve cicërojnë zogjtë
e gjethet ua mbajnë ison me pipëtimë

Këtu gjithçka i ngjan përrallës sonë
që e shpikim në një gotë me zhgënjimin
e pluhurosur

Por ç'm'u desh ky uikend
edhe jashtë vetes ta njollos simetrinë

Se tymtarët automjetet bërllogu
gojëhapur më presin t'u kthehem në mbrëmje
sërish

Duke shtrydhur nostalgjinë në këtë oazë
ndiej turpin e ikjes nga vetja

GJUETI NË SHTRIGA
Ngrihet siç ngrihet tufani
fjalë e thënë në erë

E përlan para vetes
të veja virgjëresha

Ua bën gjykimin
në kamarën e dhunimit

Në kokën e botës metastazë
E liga
Pse e bëtë jetën një gjueti
Në shtriga

Zotëri Torvemada
Inkuizitor i madh
I krimit

SODITJE
Copëdielli si pyll në flakë
fundoset duke lënë pas qefinin gri

Kurorat e rrezeve jermërisht
rikrijojnë përpëlitjen e tyre në xham

Fëmijërisht sodis këtë pamje
si këtu e dhjetë vjet më parë

Po ai perëndim dielli
por tjetër skenë në soditjen time

Kam zënë ta kuptoj mrekullinë

MUZGU
Si ushtimë pylli përhapet kumbimi
i trokut çalaman të pelës së zezë

Ajo turfullon e hakërrohet
me vringëllimë patkonjsh fik qirinjtë e dritës

Nga pamja e mugët tulaten njerëz e bimë
vetëm lakuriq farkëtohen vitheve të saj

Ninulla e natës na merr gjithëve në dorëzim

PAGJUMËSI
Orenditë koten
si korifenj të gozhduar
Në misionin e tyre të kotë

Ndez transistorin
Tinguj të një muzike të vrazhdë
shpërthejnë si gaz i nëndheshëm

Jashtë fryn
Pikat e shiut dimëror
përplasen xhamave me tërbim

Kujtoj mikun
nisjen e tij në udhë të largët
e kthimin në sarkofag bojëkafe

Tik-taku vazhdon
Akrepat kryqëzohen ashpër
Si brirë mamutësh

Një mjegull klinike shtrihet
si pauzë midis aktesh
Është gjumi që bie si vesë qumështore
Nga dora e përjetshme e mëshirës

VJESHTA
Më në fund erdhi
e zymtë flokëshprishur
si një mërgimtare e shumëvuajtur

Dhe po shkel arave trotuareve
rëndë duke derdhur vrerin
që i është lidhur në grykë

Vjeshta do të mërgojë sërish
bashkë me pikëllimin e saj të përjetshëm
Ndërsa tonin na e lë pykë në grykë

DIMËR
Peizash me një ngjyrë të vetme

Bardhësia rrënqethëse shtrihet
Boshësisë së saj vërshëllen era zemrake

Duke shkelur mbi borën këlthitëse
Provoj t’i gjej kësaj dite një copë vend
Në galerinë e gjërave të harruara

GURGDHENDËSI
E bart gurin në krah
pastaj net e ditë e vjet
mundohet të zbërthejë enigmën e fjetur

Duke u thelluar në të me daltë e çekan
shpalos si faqet e një libri enigmën e jetës

Gurgdhendës është më i rëndë guri
a dhembja që skalit në të

Më mirë lëre punën që s'është jotja
Dhe kthehu paqësor në enigmën tënde njerëzore

UJËVARA
Nga gurmazi nxjerr një rënkim të mbytur

E kreshpërohet me tërë egërsinë
gjymtyrët e veta kafshon nga tërbimi

Po atë gjëmim ndiej
sa herë mbyllen në një ëndërr të keqe
Nëse nuk e gjej si duhet derën e daljes

ARKITEKTI
Ja këtu do të ngrihet lagjja e re
ky kompleks përrallor
që po më zhurmon në kokë

Lart do të jenë apartamentet
poshtë marketet shitoret e lodrave libraritë
përballë fusha e gjelbër dhe pishat

Lagjja duhet t'i ketë të gjitha
ç'u duhet pleqve, punëtorëve, kalamajve
Si ta nxjerr në përmasat e jetës
Pa e shkelur kufirin e të vërtetës

PIRG VEGIMI

MOTIV ARBËRESH

Fryn Vetëtin dhe Gjëmon
Nga ky rrëmet llahtar
Tundet edhe dridhet Dheu

Mot i lig i tërbuar
Si në baladën shumë të lashtë
Edhe gurët vendit shkul

Rrokullisen tatëpjetë gurët
Edhe gjenden mu në majë
Të thepisur si mallkimi

NËNAT
Nisen pas yjve djemtë
E nënat mallpërgjëruarat
Ngrohen me shkarpa ëndrrash

Mësyjnë tek bien boritë djemtë
E nënat shpirtpërvëluarat
E shkojnë jetën tek portat

Mbesin fushëtirave djemtë
E nënat shamizezat
Varret në zemra ua mbajnë

Po s'u luten si luten nënat
Për shpëtimin e përjetshëm

SERGJENET
Gjithë ajo pasuri oh ç’pasuri
As në tokë as në qiell

Ftoi nga kushedi ç’vjeshtë
Molla e një vere që s’e prek harrimi

Shamia që dikur valles i printe
Zogu në dru gdhendur gjithë vegime

Gjethe të thara të blirit erëmirë
Letra të vulosura me shkretëtirë

Gjithë ajo pasuri oh ç’pasuri
Syrit të kurrkujt s’i fshehej

Muzeume mallli qenë përherë
Sall shpirti mund t’i mbante ashtu në erë

SOFRA
Shtrohej në ballë të vatrës
Re vegimi hënë e plotë

Buka u thehej të gjithëve
Edhe atyre që mungonin ngahera

Mikun në bukë s’e në prente
Edhe mik po të mos ishte

Edhe m’e rëndë ish kur çohej
Hark shprese diell i ngrirë

Ndrydhej shtrydhej veten e hante
Frymën gjallë të na e mbante

NË SHPELLËN E MERMERTË
Nëpër një portëz
Të cilën na e hap vetë ciceroni
Hyjmë në Shpellën e Mermertë

Tek ecim si të shkelnim nëpër habinë tonë
Hapat gjëmojnë bubullimë
Ndër muzgje vere të vonë

Ciceroni përmendsh si përçart flet
Për do speleologë temperaturën në shpellë
Për të panjohurën që pret

Mijëvjeçarët sipër kokash të gurëzuar
Flokët sa s'na i përkëdhelin
Si prindërit fëmijëve të llastuar

Po prapëseprapë veten e përmbajnë
Në atë gurëzim madhështor
Lotët veçse s'mund i mbajnë

Ndërsa ne vërtet asgjë nuk kuptojmë
Përderi nuk e masim kohën
Ashtu si Krijuesi e ka krijuar

PËLLUMBAT
Imazh rrënqethës krijojnë
Tek hyjnë në guvë syakuj
Tek dalin

Ajo vërtitje përmbi kulme
Ankth që bebzën rrit

Sado ulokë që të jenë
Qiellin e çukasin në rrashtë

Tek fluturojnë nëpër shqotë
Tek çojnë në vend fshehtësinë

Flatrat plumb u rëndojnë
Nga kuje netve me hënë

Ankth që bebzën rrit
Ajo vërtitje përmbi kulme
O nënë

ILION
Të mbuluan kohët me lava hiresh
Të mbuluan me mollokë gënjeshtrash

Para shkëlqimit dhe mjerimit tënd
Fjalës i ngatërrohet gjuha ndër dhëmbë

Të mbuluan kohët e ikën kokëpërgjakura
Të harruan kohët e t'u kthyen zemërplasura

Në zjarret që të shkrumbuan s'u dogj liria
Se kish humbur më parë
Në mjegullat kobsjellëse të miteve

Atë ditë e sot
Kornizë për portret s'të gjen historia

KURTHI
U nis në sa e sa luftëra
Veten duke bërë fli

Nuk qe Helena e bukur si thonë
Po bota e shëmtuar ish

E ra dhe Ilioni së fundi
Pus i thellë në atë rrugë

Po kurthit të ngrehur
S’i shpëtoi as Agamemnoni

Zgjidhte nyjë zemërimi Klitemnestra
Jo
Mirrte hak Ilioni

THEMBRA E AKILIT
E çka po të mos ktheje në betejë

Nëpër qiellin gri të antikës
Imazhe mitesh më pak do të kish

Po thembra jote do t’i bënte bisht harrimit
Kohën tonë çaltas do ta arrinte

E çka po të mos ktheje në betejë

Mallkimi që ti e barte në thembër
Atyre që harruan besën e dhënë
Edhe ashtu do t’u rëndonte në zemër

AVE CAESAR
Ave Caesar
Saç i zjarrtë mbi Dhe kurorë
Ëndrrash në mes të këputura

Ave Caesar
Edhe kur përfytem me luanin
E tërbimit tend të madh
Gjaku im qiellin kur spërkatë

Ave Caesar
Edhe kur i fundmi kuadër i jetës
Ndër bebëza më ngrihet
Me dhe kur të më mbulojnë

Ave Caesar
Që vdekjes sime i duartroket
Për tënden unë dhe do të bëhem
Dhe që në gji do të të merr

Deri në ferr

RËNIA E KARTAGJENËS
Thonë ra Kartagjena
Se qe strateg Scipioni

Thonë ra Kartagjena
Mbi hirin e saj të stërngritej Roma

Po Kartagjena s’kish si të mos binte
Përderisa hijes së vet
Dronë si një fantazme ia kishte

ARRËZA
Cingërima e orës më nxori a më mbërtheu në pezhishkën e asaj ëndrre llahtarinë e të cilës mendja s’mund e peshon
Diçka si recital robotësh diçka si kor shurdhmemecësh
Pastaj më zuri një kollë gulçitëse një ngulfame përmbytëse
E ndeza cigaren e thitha një here thellë dy tri herë
Fërkova sytë hundët theva gishtrinjtë kafshova thonjtë krova flokët
Barkzbrazët dola në rrugë shpirtzbrazët
Mure Balkone Shtylla Kartmortale Asfalte Shitore kafeçajtore
Kalimtarë Kalimtarë Kalimtarë Kalimtarë Kalimtarë
Thithin cigare përtpin çamçakëz pështyjnë reklamat shikojnë
Njerëz-gjymtyrë Njerëz-gjeste Njerëz-hije
Rruga i ngjet një skene teatri eksperimental
Ku përdhunshëm reprizohet një shfaqje pantomime
Zgjat shfaqja apo aktorët janë harruar në role të tyre
Si na u fry kështu Arrëza si na u bë digë që ndal fjalët
E si vetmia vërshëllen nga të katër anët si veri vjeshte të vonë
E na ther në shpirt për një humbje që i bëmë vetes
E një hidhërim që i bëmë Krijuesit

DIQYSH
Diqysh dolëm në qytet
Gruaja e unë me të shtatë fëmijët

Diqysh ecja aq serbes
Sa mezi e njihja veten

Te Sheshi i Fitores u ndamë
Secili të shkonte nga t'ia kishte ëndja

Unë bleva krejt ç'më duhej
Pixhame këpucë këmishë

Siç qemë marrë vesh
Te Sheshi i Fitores u takuam sërish

Të gjithë kishin blerë gjithçka
Sa mua më hante diqysh një brengë

Gjithë ato gjëra që na mungonin
Shtëpia si do të na i zinte
Ëndrra kur të më ikte

ROKENROLI
E desha sa më të dashurën vashë
Të ëndrrave të hershme djaloshare
Me të cilat përthekoja botën e madhe

Kish në të diçka farfuritëse
Që tinëzisht të rrëmbente të pushtonte
Dheun nën këmbë ta gërmonte

Po babait prapë i mjegullohej syri
Tek dëgjonte këngën për Isa Boletinin
Për të cilin të gjallë e ruante kujtimin

E nëna më kallëzonte deri vonë
Për dajë Rexhepin partizan
Që në frontin e Sremit kishte rënë

Dhe a mund ta bëje veshin shurdhër
Para tundimesh që të thërritnin
A mund t'i këmbeja me Elvis Prislin

E desha vërtet rokenrolin
Si një lodër të posablerë fëmija
Po për të unë kurrë s'do të jipja
As baltën e opingave të mia

IM BIR
Shtratin ia shtroj nga pupla përrallash
Një fjalë peng i të përkresë
Zhurmën e rrugës ninullë e ka

Të matet në diell me trimërinë
Si enigmën e lodrave ta peshojë pamundësinë

Gjumi ia zë një hutim në fytyrë
Dorën mbi një lodër që s'i zihet besë

Në ag tek nxitojmë drejt stacionit
Matet me enigmat e ëndrrave të veta
Si koha me hije
Në ka pasur kohë të ëndërrojë

PIRG VEGIMI
Shumëherë kur s’mund ta shkruash
Asnjë varg për be
Je poet i madh
Pirg vegimi je

Mëkati për arrëz të lidhet
Fjalën ta dhunon

Ti kujton ae i ditë gjitha
Të Bukurës së Dheut s ii rri kobi mbi kokë
Sytë e Homerit pse s’e kanë një lot

Danteja me ferrin pse përfytet kot
Serembeja përse shëtit i humbur nëpër botë

I ke parë me sytë e tu të gjitha shumëherë
Po a e kuptuar s’e nga u vjen humbja
Atyre që harrojnë veten përherë

QESHJE SARDONIKE

LISI
Nëpër ninëzat vagëllore
Lisit sa i duket kurora
Ai peizazh illyrizor

Përeth tij tri pelida
Syverbuara gjuhëshkurtuara
Sillen dhe gjithë drithërimë
Nga një pëllumb e mbajnë në duar

Kur i lëshojnë në dritë të qiellit
Shkulin flokët nga trishtimi

Lis Dodone rrënjënxirë
Maja Motër do të rrafshohet
Mu si varret nëpër mote

Po prapë dielli do të lindë
Zemra do të vetëtijë
Moj Dodonë harresa jonë

ENIGMË
Me të marrë lajmin e fitores
Pupthi kërceu nga froni
Mbret Agroni

Nga gëzimi i pritur
E tundi një e qeshur me zë të lartë
Sa as vetë s’dinte nga i dilte

Qeshën pas tij me radhë
Teuta që mbante Pinin në prehër
Kasnecë këshilltarë e truproje

Mbreti shtroi një gosti të madhe
Pëllumbat pa i vështruar
Edhe më keq akoma
Zotin pa e besuar

Dhe nuk e zuri pije e fortë
Librat si na e rrëfejnë
Se mos iu zu tharmi enigmës mbretërore
Në Shën Helenë

KUVADA E BRAKTISUR
Si bisha i unguronin Demetrit në zemër
Lakmia dhe trimëria

Detit ia njihte sëmundjen
Po tokës ia harronte dashurinë

Mbi shpatullat e Fulvit
Me thonj të skuqur prekte retë

Mbi shpinë të Postumit
Kafshonte mishin e trupit të vet

Kur deshi këmba dhe që t'i zinte
Në hundebuzë u rrëzua

Kohë i mbeti tepër sa ta kuptonte
Se ku kishte zënë në thua

MONEDHA E GENTIT
Në njërën anë shungullon nga deti
Në tjetrën ulërin nga mali

Im gjysh dinte ç’duhej të zgjidhte
Midis Peshkaqenit e Luanit

Rrugë të mesme s’ka thoshte gjyshi
Kur të t’i nxjerrin për fushë rropullitë

Ndoshta do ta rrafshoj Kuirinin
Ndoshta do ta rrafshoj Kuirinin

Do ta bëj ndoshta vdekjen në arenë
E të mbetem për jetë të jetëve pa varr

Oh varri im është tmerrsisht i thellë
Sytë nuk më shohin kund të tillë humnerë

Në njërën anë i shungullon nga deti
Në tjetrën i ulërin nga mali

GURËHEDHËS ILIR
Guri që është durim i moçëm
Mund të rrokulliset nga maja
Nga dora jote

Augustit plaga ende i kullon
Dhe tërbimi i gurit e zë në revan

Tek ushtojnë lugjet kushtrimi
Me shekuj në zemër i ther

Fantazma famë e tij kundron e hutuar
Deri sa i përzihen thembra e gishtërinj

Guri është durim i moçëm
Dhe rrokulliset nga maja
E lirisë së dhunuar

GJUMI I MESDITËS
Ta kesh zogun në dorë
E ta merrësh botën në sy

Të ikësh larg e më larg
Nga zëri yt
Që gjegj kur thërret

Thell të fshihesh
Në zgavrat e vetmisë
Që t'i bësh ballë shkohëzimit

Të ëndërrosh pastaj
Derisa të verbohesh
Me kokën tënde në duar

E sheh si zgjat zgjimi
Më shumë nga jeta
Popull i mashtruar

MBRESË UDHËTIMI
Gjithë ditën e lume pi kafe ekspres
Në të djathtë e në të majtë
Pluhur reklamash përdridhet
Nëpër sy më vret pagjumësia
Aq më bën
Kohën nuk e mat në akrepat e tyre
Po të kultereve të mia

Në këtë ankandqytet
Të hapur për të gjithë në çdo kohë
S'mund të blihet me çmimin fillestar
As dhe një kontinent as dhe një gjilpërë
Roje bën Liria
Me Portën Triumfale si gërshërë

Gjithë natën e lume pi kafe ekspres
Në të djathtë e në të majtë
Metro koridore katakombe moderne
Gërmojnë thellë rrënjët e lisit
Vras mendjen
Me ç'litar mund t'u matet perimetri
Mashtrimeve të Parisit

UDHËT E LARGËTA
Profesori në vendin e vet
Matej e çmatej
Me fjalët e veta

Salla sikur ngushtohej
Lapsat me gulçim
Zbraznin pikëllimin e ngjyrës

Mureve përplasej kumbimi
I ndonjë thirrjeje në mal
Iso i mbanin dallgët e detit

Murgjit rendnin të shqetësuar
Gjurmët u mbulonte shkrumbi
Hapin me të hedhur

Freskat heje akulli
Pikonin në hapësirë
Kujtimin

Po të gjithat nuk ia dilnin
Që humnerës deri te Buzuku
Urë t'i ngritnin

Ishte një harrim që shtrihej nëpër shekuj
Dhe zvarritej si memec
Pa nxjerrë një fjalë

Si e kishte harruar veten mbi hone mohimi
I magjepsur nga mitet e mashtrimet
Njeriu shqiptar

E kur mbaronte ligjërata
Salla merrte prapë formën e vet
Po honet e mohimit rrinin pezull
Edhe në ëndrra na vinin pas udhëve të largëta

MUNGESA PARA NESH
Para nesh s’ishte Numri
As matej hapësira
Nëpër nyja gishtërinjsh

Para nesh s’ishte Uji
As lundronte bota
Varkë në bebëza

S’ishte para nesh as Zjarri
Që mbush pritjen
Shkëndija psherëtimash

S’ishte kurrkund Ajri
I frymëmarrjeve të thella
Që tundin yjtë

Gjithë ajo mungesë e madhe
Deri sa e kuptuam
Se ishim të krijuar për t’u dashur
Nën këtë kurorë

SYTHA TRËNDAFILASH
Në këtë buzëqeshje të fiksuar
Një vere në det
Herbarium dashurie shpalosur
Rrudhëzat rreth sysh të rrinë

Tek t'i sodis plot mall
Kujtimet si shtjellë më përlajnë
Lëmë pas ditë e muaj e vite
Si drunj rrugësh për anë

Të kujtohet si bënim pizgrra
Me gurë nëpër syprinë
Si na arrinin valet të zemëruara
Që ua venim në lojë kaltërsinë

Dhe tek të fiksoja në këtë kuadër
Ndjeja po atë shqetësim
Si në takimin tonë të parë

Kanë kaluar shumë vera të tjera
Dhe fotografi të tjera bëmë
Po rrudhëzat rreth sysh më s't'i zura
Ashtu të çelura sytha trëndafilash

SHKUMËSAT E PIKËLLIMIT
Peizazhi i paparashikuar
Në sytë tanë plastikë
Gurë e rrasa muronte e rrënonte

Muret e dinin
Si lartësohej pamundësia

Kur binte muzgu
Në sytë tanë regëtinte
Udhët e largëta na kujtonin
E ne si fëmijët në asfalt
Vizatonim kujtimet
Me shkumësa shumëngjyrësh
Pikëllimi

HERBARIUMI FAMILJAR
Prindërit e kujdesshëm
S’e harrojnë detyrën
Në ditët e shënuara

Fëmijës i blejnë
Veturë kafshë shtëpiake
Avion supersonik plastik
Në shitoren e parë të lodrave

E puthin në njërën faqe
Ia ngrehin njërin vesh
Dhe secili mësyn
Ta zërë kohën e vet të humbur

Vetmevete thonë
Kjo është kohë e artë e fëmijës
Gjithë këto lodra që ka

Kuku për ta

FËMIJA MOLLA VETMIA
Dridhet fëmija nga mendimi
Molla kalbet në tryezë
Lodrat s’dinë për zgjim e lojë

Plagë të thellë merr shkëlqimi
Tek mjaullin vetmi e zezë
Atë që humb si ta fitojë

ARIU
Më të thellin pyll e ka shtëpi
Më të zezen shpellë e ka liri

Mijëvjeçarë të tërë atje lë gjurmët
Kurthe për shira të vjeshtës

Veç kur i ungurojnë rropullitë e sos me një
Ariu i Bardhë Ariu i Murrmë Ariu i Zi

Po s'mund të matet kurrë me faraonin
As me Neronin as Napoleonin

As me Hitlerin as me Leninin
As Musolinin as me Stalinin
Dhe as Xhingiskanin as Sllobodanin

Pleqërojeni edhe vetë njerëz të mirë
A është sa e pandehim ariu egërsirë

VAJI I FËMIJËS
Sot gjithë ditën e lume
Koka më mbeti në gazetë

Nga shtylla në shtyllë nga faqja në faqe
Bota më shndërrohej në rebus

Kronika e zezë sa s'më la pa mend
Rropullitë m'i gërreu raporti për vërshimet

Kumtesa për Inkët e Atlantidës
Në rrjetë merimange m'i vari mendimet

Shiu s'prajti as ende ka pushuar
Si ta vajtonte qielli verën e harruar

Teuta s'm'u hoq kurrë nga prehëri
Po as vajin macja e vogël nuk e mejti

Gjuante kukullën përplaste këmbët
Më shikonte mes lotësh hutueshëm e shkreta

Si nuk më bënte zemra dhe mua
Ta nxirrja kokën nga gazeta

TELEVIZORI
Butoni me shpejtësi kozmike
Ia heq kataraktin nga bebëza
Krejt botës

Përzihen pamjet humbin kuptimet
Fjalët heje akulli
Na varen buzëve

Dikush kap kokën dikush lëpihet
Tjetri fërkon sytë
Nga apatia

Butoni me shpejtësi kozmike
Katarakt të ri në bebëz i shkakton
Krejt botës

Po duhet të kalojnë disa orë drite
Derisa të na shkrihen hejet e fjalëve
Buzëve varur

GAZETA
Tek lexoja në gazetë një ditë
Një deklaratë për armatimin në gjithësi
Përvajshëm fërkoja sytë

Njeriu nga fotografia shqyhej në gaz
Si të kishte zbuluar papritmas
Një enigmë të ndërlikuar

Faqet e gazetës nëpër duar më shushurinin
Fjalët nëpër reliefin e butë të letrës
Si bishat në pyll ulërinin

Nuk dëshiroj të mirrem me hamendjen
Kobin e Atlandidës njeri a e parashikoi
Në fare deklarate në gazetë

FORMULA E KATONIT

MEDITIM PËR SAMIUN
Mote ka që trastë më rri
Figura e Samiut në kujtesë

Dhe s’gjej kuadër që ta zërë
Enciklopedinë e gjallë
Që ndjehet ngushtë në dy shekuj
Që me njërin sy e shikojnë

Dhe s’gjej kuadër që ta zërë
Dilemën bjeshkë
Gjuhën e pushtuesit si ta emërtosh
Ndryshe
Kur hijet vallëzojnë rreth shtëpisë

Se sytë zënë e djegin
Se sytë zënë e lotojnë

E atij njërën faqe ia rrahin valet në Bosfor
Tjetrën borërat në Alpe

Ka mote që ha veten e s’e di
Ç’ka qenë
Ç’është
E ç’do të bëhet me Samiun
Që ndan e bashkon dy kontinente
Me tërë atë dhembje

VIZA NË MES
Nëpër libra mësimi enciklopedi
Nën emër futur në kllapa
Si dy akrepa të ndalur
Varur rrinë dy data

Zbritja s’bëhet lehtë
Me matematikë të thatë
Ajo vizë e shkurtër në mes
Është udhë nëpër shtrëngatë

Fjalitë tutje zgjaten
Me shqetësimet e kohës
Po duken së tepërmi të ngatërruara
Si diplomacitë e Evropës

Fotografia e zverdhur përbri
Vjen disi e largët
S’është faji i fotoaparatit
Që nuancat e shpirtit s’i kap

E datat e futura në kllapa
Akrepa të ndalur rrinë
Viza e shkurtër n’mes tyre
Enigmë për historinë

DRINI NË TREG
Sa herë shoh peshq të freskët
Në hyrje të tregut
Sikur i shoh mendimet e mia
Të zëna me rrjeta
Me zorrë përfushë
Sikur i shoh kujtimet
Dhe nis e më erret
E marr në thua
Djersë të ftohta më mbulojnë
Mu në hyrje të tregut në Prishtinë

Duke ikur nga tregu
Ndjej si gumëzhin në mua pikëllimi
Si të buronte vetë Drini
E mendimet më ngelin nëpër shporta
Me zorrë për pluhur zvarriten kujtimet
Sa kur arrij me gjysmë shpirti në shtëpi
Fshihem nga pasqyra
Sytë më kanë marr një pjesë shëmtie
Nga hyrja e tregut e di

FORMULA E KATONIT
Njëherë e një kohë
Njëfarë Marcus Porcius Katoni
Shpiku njëfarë formule
Të thjeshtë për Kartagjenën
“Ceterum cenzeo Carthaginam delendam
esse”

Që s’e harronte ta shqiptonte
Në senat në shtëpi publike
Në pijetore në gjumë,
Në nevojtore

Në kohën e tij
Psikanaliza s’kishte fenerë
Për bodrumet e shpirtit

Nga ajo formulë ndjellazezë
Erërat e pikëlluara
Përhapën hirin e Kartagjenës
Në të katër anët e botës
Duke brumëzuar gjak e ëndrra
Nëpër kujtesë

Atë ditë e sot
Formula e Katonit mbeti në fuqi
Nëpër kabinete laboratorë
Salla solemne akademi
Vë veto të plotë
Dhe Kartagjenat e trilluara
I ndjek nëpër botë

MIDIS BASHKËFSHATARËVE
Pas kaq kohësh prapë jam midis bashkëfshatarëve
Në ditën e shkollës

Me sy i vjedh burrat
Që janë bërë grumbull në banga të fundit
Si të qenë strehuar nga shiu

Kohë e mbjelljeve
Po ata kanë ardhur të dëgjojnë vjersha
T'u duartrokasin fëmijëve

Kështu vinte edhe im atë
Kur recitoja vjersha në ditën e shkollës
E gëzimi i stiste mustaqet

Prapë jam midis bashkëfshatarëve
Dhe ndjej atë gëzim të largët të harruar
Si një fjali që e lexojmë në dërrasë
Të pafshirë nga ora e kaluar

COPA METALI NËPËR GISHTËRINJ
Kthehem nga puna
Pa një fije gëzimi
Në shtëpi

Dreka e ngrirë
Pasditë të gjatë më premton

Futem nën batanije
Dhe vështroj rebusët e merimangave

Zërat e fëmijëve ecjaket e gruas
Si të qenë fshehur nën tapiceri

Numëroj ditët e mbetura
Si ushtari i vjetër
Copa metali më rëndojnë
Nëpër gishtërinj

Dhe s’gjej fjalë t’u shpreh dashurinë
Për sa m’i japin kuptim jetës
Kur të vijnë

THIRRMË
Posa cingëroi telefoni
Hodha gazetën i lehtësuar
Dhe pas fjalëve të para
Njeriu filloi të më kërkonte ndjesë
Si t’ma kishte kanosur jetën

Unë i thashë se më gëzoi ajo thirrmë
Po ai s’më zuri besë

Ishte dita e dytë vërtet
Që s’më kishte kërkuar njeri

Dhe unë përfytyroja receptorë të ngritur
Gishtërinj që formonin numrin tim
Qoftë edhe gabimisht
Po ec e mbushja mendjen atij

BUBULINA
Erdhi një natë tetori
Me vaj në buzë Bubulina

Ç’vaj
Me bubullimën e lashtë të jetës

Dhe hyri në albumin e jetës sonë
Ku vendi i vet e priste

Tash kaltëron Jonit të gëzimeve tona
Me emrin që kohët përtërin

ALBUM PËRMALLIMI
Shkrepi muzgu fyshekzare
Tym e plhur rigë e erë
Po qyteti s’u mbush vrer
Si far’ vashe lajkatare

Rri i muzgët në dritare
Rrugët mbushen me poterë
Stinë trillesh ti o verë
Di të therësh me thikare

N’kryq vetmie të gozhduar
Pre më bëre të kujtimit
Të njëmuzgu të muzguar

Jap e marr tash me rininë
Në album të përmallimit
Loti fsheh fotografinë

PLANETË TË LARGËT
Përgjatë shpirtit tonë shtrihen
Këneta hënore
Dhe Oqeane Stuhish

Për t’i vënë re
S’ndihmojnë kurrfarë planetografish

Po një ndarje e përjetshme
I bën të dukshme ato humnera
Në planetët e largët në ne
Kur na braktis shpresa

ETHET E KUJTIMEVE
Shëtitorja u kërrus
E mbahet si për bastun
Për trungjet tullace të brirëve

Gjethet me verdhëz
Ia mbulojnë kurrizin
Që therje reumatike ndjen

Derisa bëj shëtitjen e mbrëmjes
Sa s'ia plas vajit
Për verën e dashurisë së vdekur

Ndalem në mes të shëtitores
Si për t'i mbledhur kujtimet
Nëpër plasat e asfaltit

Më mirë po t'i varim si kartëmortale
Se kështu na i shpiejnë në pleh
Fshisaxhinjtë

DRITARJA
Është sy
Të nxjerr nga thonjtë e mureve
Po dhe të bën sylesh

Prandaj ti mos rri
Kohë të gjatë përpara saj
As në festa as në zi

SHPRESË NË FACULETË
Në të njëjtën kthesë të bulevardit
Rri verë e dimër pranverë e vjeshtë
Të njëjtin refren çamçakëz mbllaçit
Në prehër e mban të njëjtën faculetë

Në lustrën e kohës gravure e gjallë
Fytyrë-thëngjill e syzgurdulluar
Gjimnastikën e përsosur të përuljes bën
Përpara hundës së botës së verbuar

Si një aktor e di krejt përmendsh
Tekstin e rolit që luan në jetë
Di ta shumëzoj mëshirën e huaj
E ta pjesëtojë dhembjen e vet

Në të njëjtën kthesë të bulevardit
Që nga mëngjesi e derisa bie terri
Faculeta ia zë gjithë atë shpresë
Siç e zë ekrani një film tmerri

LLAHTARIA
Shëtitorja e mbuluar gjethe blirësh
Fara kungujsh buleta kinemash gëzhoja gështenjash
Nuk zhurmërin si rëndom në këtë orë të mbrëmjes

Po unë me një mikun tim regjisor
Shëtisim që nga Theatri e deri te Hotel Grandi
Nëpër fyryfyçkë këmbë pas këmbe mes blirëve
Bëjmë biseda të rëndomta për të shkuarën për ardhmërinë

Dhe s'di hiq se si e nxjerr ai fjalën te armatimi bërthamor
Duke qëruar fara të kriposura kungulli e duke pështyrë
Duke qeshur nganjëherë me zë të lartë e duke sharë

Ndërsa mua më bëhet se merr flakë vetë qielli
Se zbret mbi ndërtesat blirët shëtitësit e mërdhirë
Që zënë të përpëliten nga llahtaria
E miku vazhdon ta ndrydhë butonin e fjalëve
Që si bomba eksplodojnë në përfytyrimin tim
Sa s'shkrihet së qeshuri kur e lus të ndërrojë bisedë

Kur e lë mes shëtitores e ik për në banesë
Ku posa hyj brenda
Redaktori në TV po atë temë paralajmëron në krye të ditarit

Ai veçse s'qëron fara s'qesh s'pështyn s'shan
Mirëpo arrëzën e fytit e shtyp me gisht
Kravatën shumëngjyrëshe e çliron spontanisht
E unë përpiqem ta shkul përfytyrimin llahtar

Që si etiketë mbi shishe në tru ma ngjiti miku
Derisa në ekran emetohet shpërthimi në Nevadë

STADIUMI
Kur i hapëm themelet
Shtangëm nga habia

U ngjitëm në Dragodan
T’na hipi në kokë një marrëzi

Gooool brohorisnim përnjëherë
Dhe kapelat i hidhnim për qiell

Shpirti ashtu na lehtësohej
Për token që nga hekuri do të rëndohej

Më rrëfen një pensionist
E qesh rëndë e bën me gisht

E di thotë se po të bëhem cergë
Veçse po të më pyesnin mua

Emrat tanë do t’i shënoja në ulëse
Në vend të numrave

KUJTIM
I PALEXUESHËM
Në një mbrëmje si kjo
Shëtitësit do të ndalen për një çast
Para trungjeve të blirëve

Do të tund ndonjëri kokën
Duke nxjerrë nga xhepi një cigare
Po mbrëmë ja këtu e pashë
Do të bëjë tjetri me dorë

Pastaj do të nxitojnë
Të arrijnë atje tek i presin
Duke shkelur pikëllimin e çastit
Si gjethet e rëna

Dikur dikush do ta shkulë kartëmortalen
Për të shënuar një numër telefoni
Apo shiu vetë do ta bëjë të palexueshëm
Kujtimin

ARTI I KRIJIMIT
Në letër i nxjerr
Mendimet që më tundin
Si trollin tërmetet

Titullin që më parë ua di
Në vesh sekush ma dikton

Po pa një pa dy ai merr zjarr
Shkronjat si zhavor
Për fytyrë m'i përplas

Vija e drejtë që e mban
Si gjarpër zë e përdridhet
Kaligrafinë e frymëzimit
Në zemër ma kafshon

Nga zëra të njohur të largët
Dora në ajër më shtanget
Aniqë letra e bardhë ma tërheq
Si metalin një copë magnet

Dhe s'di ç'të hedh më parë në letër
Me ç'fjalë me ç'ritëm
Në ç'metër

E taketukja mbushet shpuzë e mbushen
Mushkëritë tym e nikotinë
Dhe ngryset natë dhe çel dita
Në betejën time me afazinë

Edhe kur s'e shkruaj një fjalë
Letrën nuk e gris

Se titulli do të më ndiqte
Fjalët e pashkruara mendimet e pathëna
Do të krijonin pas meje ortiqe

DRITHËRIMA
Llampa me tytë përmbi letër
Nga ritmet e dorës drithërin

E drithërijnë zogjtë e tapicerive
Lulet e perdeve të mëndafshta

Fiku me gjithë vazë drithërin
Drithërin piktura me kornizë

Nëpër hapësirën e dhomës drithërijnë
Trupi dhe gjymtyrët e mia

Nëpër këtë bulërimë drithërimash
Merr formë poezia

KURS PËR PANTOMIMË

PALIMPSEST
Orakulli i Dodonës Taksa Ilirike
Zjarret e Pal Emilit Itinerari i Antoninit
Mbushin sterën e orëve
Me ujëra të turbullt të shekujve

Si më mbiu nga zonë e muzgët në ndërgjegje
I krijuar nga copëza të shuara meteorësh
Poeti anonim
Që krijonte vargje në Pallatin Mbretëror

Dhoma u shndërrua në shkëmb
Ku përplasen valet e bardha të Adriatikut
Dhe ora e murit në ninëz
Ku derdhen si rërë format e hënës

Kur i thashë hirësisë me zë të prerë
Që premiera s'mund të shtyhej për një betejë
Se vargjet më mirë nga shpatat
Dinë ta mbrojnë Ilirinë
Atij i kërceu zemërimi mbretëror

Oh ç'tmerr kur ta nxjerrin me thikë
Dritën e fundit nga bebëzat
Peizazhin e atdheut të larë në gjak

Edhe me tërë atë dhembje
Unë i thashë përmendësh të 40 mijë vargjet
E Iliriadës
Po ato si trumcakë të trembur e të mpirë
U shpërndanë nëpër muzg
U fundosën bashkë me shpirtin

Vetëm atje ju mbetet t’i kërkoni
Se zjarret përmbi i bënë shkrumb e hi

Nuk di sa herë ndërrojnë format e hënës
Derisa ato copëza meteorësh
Më lënë të kthehem në kohën time
Në këtë antiantikë klinike
Ku nata e acartë e janarit është gëzof i ngrohtë
Po edhe këto vargje të shkruara vonë vonë
Unë i nxjerr në letër ai m’i dikton

MBROJTËSIT E ILIRISË
Ç’gjarpërinj
Dalin kështu nga ndërgjegja e shekujve
Si nga plasa shkëmbinjsh
Dhe lëvizin në forma spirale në forma valore
Nëpër ajër nëpër mure perde
Nën tavolinë
Pranë këmbëve të mia akull
Derisa rikrijoi vargjet për Ilirinë

Hutimi ndez reflektorët e vet
Edhe majën e lapsit
Në thimth ma shndërron
Dhe hapësirën e tërë në një rrotullimë

Janë kadmi dhe Harmonia
Me ndonjë enigmë të re
Në pleqërinë e tyre të thellë
Dhe vetë Ai që Illit ia dhuroi fuqinë

Janë dhe bijtë e harruar
Nga nekropolat e Hollmit Dimalit Prishtinës
Nga kiçët e anijeve labeate
Nga shkopi i Eskulapit
Monedha e Hvarit

Vijnë si mbrojtës të vatrës
Kësaj hapësire të prerë

Vijnë si kasnecë të një tjetër ndëshkimi
Për dvarjen tone
Apo si shenja

Se do mbështillemi me fuqi të re
Në vorbull të këtij pësimi

Maja e lapsit nxjerr zëra fjalë
Që e bëjnë thërmia afazinë
Dhe gjarpërinjtë zënë të kthehen
Në hapësirat e ngurosura të shekujve
Ku ata e shenjojnë humbjen
Ilirinë

OKTAVIANA
Ndërron forma si plastmasë
Kur e ndrydh e shtrydh ndërgjegja
Oktaviana

Nga bodrumet e errëta i çelen kaverna
Pamjet e grave dalmate
Tek hidhen me fëmijët ngryk në flakë
Nëpër shkallare
Mollokë të përgjakur rrokullisen
Koka të prera me shpatë

Karnel Scipion Nazika, Tiberi
Dhe vetë Oktaviani
Në kulmin që hepohet pozojnë
Si terminatorë të shprogramuar

Thonjtë e gjakosur u prekin në re
Thonjtë që ia kanë ngulur në fyt
Si deles Delminiumit

Amulet i krimit në emër të qytetërimit
Është Oktaviana
Që ndërron forma si plastmasë
Kur e ndrydh dhe shtrydh ndërgjegja
Mermerin e saj

GEMMA AUGUSTEA
Si s’ke një grimë turp
Nga ajo kapardisje August
Që si lakmus ta zbulon mizorinë

Po bëri e u rebelua Bato
Copë e grimë e bën atë skulpturë
E bëhesh gazi i botës
Në sy të spektatorëve
Në Museum Naturhistorischen
Në Vjenë

NË ADRENICË
Një qen i zgjebosur
Që mezi merr frymë me gjuhë jashtë në hije
Dhe një burrë i trembur
Me gurin përkresë
Bëjnë roje në atë portë

Ky do të jetë ai luftëtari ilir
Që ka këmbyer gjarpërin me një qen
Dhe zoti e ka ndëshkuar

Mizat s’e lënë të qetë a ndërgjegja
Shihe si dromcohet
Si të ishte i tëri argjilor

Brenda na pret Konstantin Shpataraku
Dhe ora me mozaikë të mermertë
Ku koha është paralizuar

FORMA TË REVE
Përse me emra kaq të paarritshëm
Si format e reve në një qiell
Që s’paralajmëron asgjë
Molosë taulantë penestë
Enkelejë pirustë liburnë dasaretë
Albanë dardanë breukë dalmatë
E të tjerë emra që shprishen pambarim
Në një zonë të shurdhër harrimi

Mos ishte një ndëshkim perëndie
Apo gënjyet veten se bëhemi më të lirë
Të ndarë me qindra emra e kufinj
E jo të bashkuar me një të vetëm
Ilir

NË BUTRINT
Si t’i kuptoj këta gurë
Këta memecë madhështorë
Që as përpjekje bëjnë të dëftojnë
Kush ishte këtu spektatorë
Tragjeditë kush i deklamonte
Shi a binte si sot
Para dy mijë vjetësh
Cili burrë matej me Hektorin
Po s’hyri në mbretërinë e shkronjave
Të vetmit kenotaf të përjetshëm

Nardi sa s’e humb drejtpeshimin
Ti në të vërtetë je Glauku kur i them
Ai aktor që e dinte përmendësh
Iliriadën

Në përhumbjen time amfiteatri tkurret
Si iriq si kërmill si breshkë
Dhe unë ulem në një gur
Të lagem deri në palcë
Mos nxjerr vuajtja gjë nga enigma

Selvitë ma përkundin hutimin
A për mua vjatojnë
Që s’i kuptoj këta gurë
Që s’shndërrohen në shkronja
Në fjalë

NË PLAZHIN E DIKTATORIT NË VLORË
A mund t’ia kthjellonte mendimet
Që i nxinin si radiografi tumori
Ky ujë kristalor

Po këta miliona guralecë
Tek shkelte mbi ta gjithë zemërim
A e ndienin veten simahorë

Karaburuni a e ulte kreshtën
Kur e qëllonin citate emra të huaj
Si breshëri me automatik

E ruajmë plazhin po si mos ta ruajmë
Thotë një ushtar e buzëqesh
E ruajmë nga shpirti i tij i lig

Ç’ËSHTË ATDHEU
Atdheut hija ime
Nuk është lehtë t’i thuash lamtumirë
Çfarëdo që ta kesh

Në secilin hap që ta lësh prapa
Ai shformësohet si një ëndërr

Po ç’është atdheu hija ime
Që fërgëllon kaq e zemëruar
Dhe ekuilibrin ma prish
Duke më shndërruar në plastmasë
Apo vetëm mirazhet mjegullore
Të hapësirave ilire
Që janë strukur nëpër kronika
Si fatzinjtë në kullat e ngujimit
Të qyteteve të bëra shkrumb nga Pal Emili
Të kështjellave të rrënuara
Që sikur u bëhen bastunë
Tradhtive ideologjive hemorragjive
Bëkan kuptimin e atdheut
Hija ime
Që fërgëllon krejt e tërbuar
Po pse po më braktis dhe ti mua

A KËSHTU TË ZËKA MALIKIMI
Nga këto pamje halucinante
Sytë sa s’më pëlcasin

As syzat e Reja Çarlsit
S’do të mund të më ndihmonin
Që t’u shpëtoja thikave të helmuara
Të këtyre mbishkrimeve
Nogdaunëve të këtyre kumbonareve
Që më shkaktojnë amnezi
Grisë së këtyre fasadave
Që m’i ngre flokët përpjetë
Tek ngërdheshet si robot i rebeluar

E dinë se jam krejt i huaj
Dhe m’i ngulin gjilpërat e frikës
Në retina
Që t’i ndjekin si kusarë
Peizazhet e atdheut

Të plaçin sytë mos
Më thoshte nëna kur u nisa
Dhe gërvishte fytyrën e vet
Si pelidat në Dodonë
Kur fatthënën në fluturimet e pëllumbave
Parashikonin

A kështu të zëka mallkimi
Oh nënë

NATA E HUAJ
Më mirë po e lë dritën ndezur
Se errësira që përgjon si kusar
Prodhon dorëza të zeza
Që me një shtrëngim gjakun ta nxjerrin
Për gojë
Nofulla të deformuara
Që kafshojnë si hienat
Më mirë po e lë ndezur dritën
Dhe derisa të më zërë një kllapi
Po mendoj diçka optimiste
Për atdheun tim që si një copëndërr
Më shformësohet në kujtesë

Ndoshta kështu e shporr nga vetja
Këtë Natë të Valpurgës

NJË MËNGJES I ZAKONSHËM
Zogjë e murrmë të tapicerisë
M’u futën me dhunë në retina
Edhe këtë mëngjes

Kot mbyll sytë me shuplaka
Ata vazhdojnë të rimarrin forma
Të bëjnë fole në kujtesë

Ndez tranzistorin
Fëmijë shqiptarë nga Bazeli
Me një shqipe të çalë recitojnë vargje
Për shqiptarët jashtë atdheut

Dhe si zogj të trembur tapicerie
Më rimarrin forma në lotë

Akulli paskësh mbërthyer xhamet
Figura të mistershme pritkan deshifrimin
Edhe këtë mëngjes

Të ngrihem apo të rri shtrirë
Ta dija Kasandra e akullt ç’parathot
O Zot

NDRYSHK NË FJALË
Formoj numrin 999026153160
Dhe nëpër mendje më fluturojnë
Vijat e bardha të asfalteve
Peizazhet e verdha të Edrenesë
Ura gojëhapur e Gallates
Derisa nga receptorin Hikmeti
Atje në Arifi të Anadollit
Hikmet Zeqir Çarktani
I Zeqir Tahir Gjakes

Po pastaj më erret dhoma
Derisa ai flet
Ngase fjalët vijnë gjithë gërvima
Si të kishin zënë ndryshk në rrënjë
Si t'i kishin varrosur lidhëzat
Në atë moçalishtë të uritur
Dhe zë e më mungon ajri
Për atë ndryshkë në fjalë që ntrashet atje
Si në Kalabri si në More

PËRRALLA PËR UDHËN QË S’KTHEN
A thua janë pjekur tashmë ullinjtë
Në Arifi
A pikin vetiu nga rrembat
E rrokullisen kodrinës
Deri në liqen

A thua shëtit ende Ali Gjakja
Tërë ditën e lume nëpër ullishtë
Duke kërkuar shëmbëllesa
Me fytyrën mjegullore të atdheut
Që e la e më s’e pa

Mos janë kalbur tashmë ullinjtë
E mbetur veç bërthamat
Dhe Ali Gjakja vetë rrokulliste kodrinës
T’i lajë sytë në liqen
Që t’i kujtohet më e plotë
Përralla për Udhën që s’kthen

KURS PËR PANTOMIMË

Me pamjen e një kuçedre që ka dalur nga përralla e frikshme, arrin Akropolisi në Fushë-Kosovë. Ia bashkangjesin dy vagonë të klasit të dytë në dritaret e të cilëve, në gjuhë të huaj, shkruan mos u kacavar jashtë. Platoja e stacionit kërruset si njeri me spondilozë nga dhembjet e ndarjeve. Ata përshëndesin nga dritaret deri sa u humb sysh stacioni, pastaj ulen dhe pinë duhan e nëpër shtëllungat e tymit vjedhin me sy njëritjetrin. Secili është behoviorist më vete. Akropolisi e di stacionin e vet të fundit prandaj ata ia kanë lakmi.

Dikur vonë i mashtron gjumi. As e ndiejnë kundërmimin e rëndë të çorapëve, as rënkimin e binarëve ngase lodhja ua shtron një çilim përplot ëndrra që ndërrojnë orë e çast si peizazhet e tokës së huaj. Futen nëpër ëndrra belbëzimet e fëmijëve, shikimet plot mall të grave, lutjet e nënave, shtëpitë e vendlindjes, zhurmërimat e stacioneve, pamjet e qyteteve të ardhshëm, gishtat tregues të pronarëve, barrakat e punëtorëve, veturat luksoze, reklamat marramendëse, shtëpitë publike… Rrotullohen nga njëri krah në tjetrin duke fërkuar qafën a dorën e mpirë dhe vazhdojnë të përplasen nëpër hapësirat e gjymtuara të ëndrrave deri sa të vijë zbardhëllimi i ditës së re kur shohin mbishkrimin: “und hier haben sin den termindienst Auf einen blick…” dhe reproduksionet e freskave që thuase janë shkruar me alfabetin e vetë tjetërsimit.

Ditët shkojnë të ngarkuara me peshën e mërzisë mu si vagonët e klasit të dytë e shtrojnë kalldrëme të gurta moshe e vuajtjeje. Mbrëmjeve ulen e shkruajnë letra

po gjumi i zë mbi toç u mungojnë fjalët për ta shprehur mallin e dhembjenç më kot ndrydhin tamthat të krijojnë një figurë me pamje atdheuç janë kryeneçe fjalët dhe mendimi zbehet si fotografi e vjetër në tavolinë. Dalëngadalë shndërrohen në pantomistë. Mallin e dhembjen s'kanë si ta shprehin ndryshe vetëm duke valvitur a grisur valutën e fortë në mes të sheshit.

NDARJA NË QAFËTHANË
Brymë pikëllime
Zuri t’i mbulonte fjalët
Sapo drodhëm udhën për Qafëthanë

Ai peizazh në muzg
Ftohtësi klinike kishte

Vijat e bardha të asfaltit
Dhe gurët kilometrikë
Lëviznin si gjymtyrë me frakturë

Dhe pastaj
Gishti tregues i policit
Shikimi i hekurt i doganierit
E ndarja pa asnjë fjalë

Duart tona të mpira
Nëpër muzg krionin hartën e saj

Hapat më të rëndë se gurët e kufirit
Dëftonin
Sa e ngushtë është kjo Qafë
Që atdheun na e ndan
A do të pëlcasë një ditë nga pikëllimi
Ilirian

DREKË POLICËSH SERBË TE URA E FSHEJTË
Peshqit notojnë nëpër yndyrë
Pirunët e tyre i ndjekin
Nëpër thellësitë e pjatancave

Njëri nga policët ia drejton automatikun
Këmbës së majtë të urës
Atje dy fëmijë luajnë me rërë

Tre policët tjerë zgërdhihen
Hedhin bast cakrrojnë gotat

Ura e Fshejtë dridhet nga frika
Në sytë e njerëzve

Rafalet mund t'i qëllojnë edhe fëmijët
E lëre më legjendën

MURI I BERLINIT
Këtu ishte halucinant ai Mur
Që ndante dy botëra
Një popull
Thotë Ahmeti
Dhe tund në ajër
Pasaportën e emigrantit politik

Aty përbri shkruan
Den Opfern der Geëalt
Dhe emra të të vrarëve
Si kufoma të ngrira në një morg
Udo Dullick 5 tetor 1961
Vinfried Frendberg mars 1986
Që kishte provuar ta kalonte Murin
Me balon të ajrit

Tash një cope Mur
E mbështjellë me porcelan
Shitet pesë marka
Ndërsa gurvarret e mermerta
Notojnë turbull nëpër kujtesë

SYRI NË ZARFË TË VULOSUR
A e njihni Hasan Qorrin
Me atë shall të bardhë mbi sy
Tash dyzet e pesë vjet
Atë burrë që flet vetmevete
Merr në thua nëpër gurë
Që kur ulet ndanë udhe
Me gishtin tregues vizaton hartën
Nga Nyrmbergu deri në Breznicë

Njëri sy më mbeti atje thotë
Edhe tash më bëhet se më kërkon
Nëpër tymnajën e krematoriumit

Për shpirt të shokëve
Nuk më dhimbset

Po ai do të më gjejë një ditë
Do të më vijë në një zarfë të vulosur
Në vend të pensionit

MUNGESA E LIRISË
I bërë dhe më sterrë nga retë
Që tërë kohën s’e ndalin vajtimin
Qytetin e pushtoi veladoni i zi
I këtij muzgu klinik

U shormësuan shtëpitë blirët
Siç shformësohen vizatimet në rërë
Kur mbi to shkilet me zemërim
Fragmentet e tyre si lakuriqë rendin
Nëpër retina

I ngujuar në dhomë
Si dhjetëra herë nga orët policore
Ndjej marramendjen e këtij shormësimi
Dhe prekjet e hekurta të vetmisë

Telefoni s’cingëron
Ai të paktën të ndjehej i gjallë në shtëpi

Miqtë më kanë harruar
Emrin nga notesat ma kanë fshirë
Si një fjalë të shkruar në tabelë gabimisht
Apo edhe ata kështu të ngujuar
Ndiejnë puslin e çrregullt të shformësimit

Ky muzg klinik po e bën më të plotë
Mungesën e lirisë
Që aq shumë përpiqemi t’ia fshehim vetes

SPONDILOZË

Më shumë se nga mosha, blirët e kryeqytetit janë kërrusur nga spondiloza e dhembjes. U kemi ngarkuar një barrë tepër të rëndë, kartëmortale të panumërta. Kur ndalem para tyre për të mësuar emrat e të ndjerëve, sikur më thonë: këtë dhembje më lehtë mund ta duroni ju njerëzit, ne jemi më të ndjeshëm. Më therin në shpirt blirët e kryeqytetit. Druaj se do të kërrusen edhe më e do të bien pa shpirt në asfalt. Ku do t'i vëmë kartëmortalet pastaj? Ku do ta ekspozojmë vdekjen?

LIMANI LIMON

Libraria e vockël, me dritare të hapura, thuase u druan shikimeve mospërfillëse të kalimtarëve. Merr frymë si një astmatik libraria. Homeri është aty dhe s'lëviz mesa një mumie. Ai apo të tjerët janë të verbër? Barleti duket i dëshpëruar që nuk ia përfillin dëshmitë. Dante, i dënuar në mungesë, për të satën herë sheh ferrin në dritë të diellit. Ndiej pikëllimin e tyre si puslin e shpejtuar. Pluhuri i ka bërë të ashpra, si ndjenjat tona, kopertinat. Xha Limani kruan kokën dhe hesht. Xha Limani i bërë limon.

I MBËRTHYER NË KORNIZË
Ditën e tetë të urisë
I gozhduar për një shtrat fushor
Që pehatet si urë në ëndërr
Nga kati i shtatë i ngujuar
Shikoj për dritare

Kodra e Diellit
Në malet e Gërmisë si samar breshke
Dhe retë e bardha përmbi
Më noton nëpër begëza
Si një pikturë naïve e sapo përfunduar

Motra ma sjell një aspirinë
Dhe më këshillon
T'i ruaj sytë nga drita
Edhe fytyra e saj
Me atë buzëqeshje të fshehtë
Në një pikturë renesanse më përngjet

Mbyll sytë ta vazhdoj kllapinë
Dhe ndiej se si ngadalë
Shndërrohem i tëri në portret
I mbërthyer për vdekje në kornizë

NATYRË E VDEKUR
Një ngjyrë e amullt
Pëlhurë në sy

Harta topografike
Tkurret në mes thonjve
Me shekuj të paprerë
Të përgjakur

Një bisht sopate
Dhe një kishëz
Për ta theksuar krenarinë

Vetëm nuansat zbehen
Po ç'janë nuansat
Për këtë Natyrë të Vdekur

VEREMI
Veremosem
Nga ajo gjakftohtësi
Leksikografësh

Përse s’e hoqën
Nga fjalori të paktën
Atë fjalë

VDEKJA VJEN VETËM
Kur vdekja si çukapik çukatë
Dhe krijon zgavrat e zeza
Të dhembjes tënde kozmike
Të duhet hapi i elefantit
Të nisesh kalli vetëm
Të dalësh jashtë hapësirës që të rrethon
Sepse kërthiza të ka ndarë
Nga të tjerët përgjithnjë

Nëse mbahesh për litarin e vërtetë
Do të vezullosh
Si një copë fildish
Në xhunglën e kujtimit
Të kësaj bote

Ndërsa lulja e shpëtimit
A të mbinë për përjetësinë
Varet nga vetë vepra jote

KËNGA E GJELIT
Është afazi që paralajmëron vdekjen
E ëndrrave
Mundësinë e thikës në lafshë
Gjakun e zi në borë

Është fërgëllimë që tund mjegullat
E kujtimeve
Perdet e mistershme të gravitacionit
Hijen e përbaltur të kasnecit gjuhëprerë

Është vetëtimë që ndriçon greminën
Kozmike
Burimin e fshehtë të jetës
Ku luajmë fugimthi me veten

DALJA E ATDHEUT EDHE NGA ËNDRRAT

VAJTIM KOMBËTAR
Në këtë rrafshnaltë dardane
Ku farë na mbolle me dorën tënde
Të përjetshme
Dhe na stolise dritë e dëshira
Fryn erë asgjësuese o Zot

Kërcëllimë e saj na tmerron
Shkulim flokët nga dëshpërimi
Me shpirtin e lagaterrshëm në ankth
Ngrihemi e ngrysemi

Po edhe me këtë akullsi në palcë
Ne presim çastin kur fytyra jote e ndritshme
Do të na e dëftojë ylberin e lirisë
Atë vezullim që ishte filli i ngjizjes sonë

RRËFIM KOMBËTAR
Ishte e gjitha tokë e shenjtë o Zot
Na e dhurove në ag të Zanafillës
Si një amulet të çmuar ta ruajmë
Për shpirtin tonë e madhërimin Tënd

Kupën qiellore që e kishim kësulë
Ekuilibrin që e kishim dhuratë
I humbëm në lojën fugimthi
Në zonën e muzgët të tradhtisë

Tash na duhet ta rikrijojmë o Zot
Fytyrën e plotë të atdheut
Si portretin në një gravure të thyer
Ta zbulojmë bashkë me ndihmën Tënde
Në gjithkahnajën tonë të shpirtit

KËNGË RIATDHESIMI
Marrin udhët djemtë natën
Nëpër hone cytanike eksodi
Në çdo hap shkelin mbi mandatën
Dridhen ata dhe dridhet globi

Ua ndjellin kthimin nënat
Duke u hedhur ujë thëngjijve
Ikin të premtet e të hënat
Me kujet e kulmeve të shtëpive

Po ata një ditë do të kthehen
Të dëshëruar e me shpirtin plot
Mall e dashuri këtu të prehen
Ndihi në këtë rrugë o Zot

BATO DESIDIATI
Shën Helenën tuaj për të cilën vajtoni
E kam jetuar në Ravenë
Në shkëmbinjtë e saj funebër
Tiberi s’ma kurseu jetën nga mëshira
Po nga urrejtja më e egër

Ditët në ravenë ishin mileniume
Netët ankthe që bymeheshin pambarim
Sodisja si Ikari humnerat e qiellit
Po shpirti si pus i thellë
Shteronte në kotësi e trishtim

Tiberi po ma vriste lavdinë ngadalë
Me arsenin e tmerrshëm të harrimit
Më zbardheshin flokët më lëbyreshin sytë
Iliria po më shfytyronte në trurin e saj
Të shtrydhur nga dorë e krimit

Ajo i ndjeu e para tinëzitë e Shën Helenës
Në shkëmbinjtë funebër të Ravenës

PO AJO NATË PA HANË
Me zë të tejkohshëm
Klithmëprerë më thotë
Një natë pa hanë

Na bënë rresht për një
E na thanë
Ju s’jeni dardanë

Na vunë në trekëmbësh
E na thanë
Ju s’jeni albanë

Na groposën thellë
E thanë
Këtë fare as dheu s’e mban

Një zë i tejkohshëm
Klithmëprerë më thotë
Një natë pa hanë

Natë që m’i mbulon shekujt
Anembanë

KOHA AH KOHA
Një lopë e larme kullot me ëndje
Aq i bën për arenën
Me mozaikë të mermertë
Shtatë pash nën këmbët e saj
Për vizitorët që fotografohen
Duke matur me sy perimetrin e qytetit
Pa kuptuar kurrgjë

Nga kthinat e errëta s'dalin luanët
As gladiatorët e tmerruar
Po fëmijë të maskuar
Që luajnë kukamshefthi

Minush Jero shtangur si statujë
Më duket se thinjet në çast
Nga oksidimi i heshtjes

Koha ah koha
Mos është vetë kjo këmbanë
Që tringëllin në qafën e kësaj lope të bardhë

MESDITË NË GËZHOJË
A mund të vdesë sot në vend timin
Kjo mesditë e përcëlluar
Si gështenjë e çarë në mes
Në këtë qytet të kërrusur si urë
Të mos merr frymë të mos lëvizë gjymtyrët
Si e vdekur të shtiret
Ndërsa unë
Të hesht derisa të pëlcas
Pa e vrarë mendjen
A i dridhen themelet Shtëpisë së Lidhjes
Shpirtit a i dridhet Kalaja
Sharri a është shpatë që pret mes për mes

Po mesdita tajon në gëzhojë
E lirë si kërmill

Në vend timin vdes tjetër gjë
Në akrepat e paralizuar
Për të miliontën herë vdes e rilindet
Në këtë vend liria

TËRMET NË NDËRGJEGJE
I thinjur si bashkë reje
Shkëputur nga vranësirë e tejkohshme
Pranë meje ulur në gjunjë
Asturiasi më thotë
Therje në shpirt është Peleleja
Po më shumë portat që mbyllen
Dhe fjalët
Që s'mund ta shqiptojnë dhimbjen
E nënës që mëkon fëmijën e vdekur
Fidani i vrarë në rrugët e Kosovës
Është po ai fëmija
I vrarë me paramendim në burgun e
Guatemalës
Ai i ndien klithmat
Si përplasen nëpër dhëmbët e shkëmbinjve
E thërrmohen në shpirt
Dhe i errësojnë azimutet në ninëza
Kot mbyllen portat sytë veshët
Asturiasi më thotë

NJË CEP QIELLI PËRMBYSET
U err
Djali ende s’u kthye

Hijet e sendeve kërcejnë
E zgërdhihen
Ekrani shtie me breshëri
Një copë qielli përmbyset

Djali ende s’u kthye
Orë policore ankthi u err

GJYMTYRË ME FRAKTURË
Zgjimi në orën 2,55 për shembull
Është më i tmerrshëm nga një sulm epileptik
Nëpër binarët e ngatërruar të trurit
Dhjetëra vagonë përfytyrimesh përplasen
Dikush numëron nga dhjeta deri në një kot
Evropa e Karl fon Tririt fundoset në ujë
Dorëza të zeza shtrëngojnë qafën e një fëmije
Një grua në ballkon mbledh rrobat e thara
O zot ç'grua epshndjellëse tek zë e zhvishet
Lakuriq bën me dorë e zgërdhihet
Ujë i turbullt sulmon urën e drunjtë
Një varg dridhet nën rrënojat e frymëzimit
E shformësohet botë e tërë e tij si plastmas
Në portë trokitjet bëhen shurdhuese në tru
Krejt jeta përplaset e thyhet si qelq
Ndërsa akrepat lëvizin me druajtje
Si gjymtyrë me fraktura në klinikë

Kur pesha e mëkateve në vuajtje
Shndërrohet

SHUMËZIMI I FYTYRËS
Për të mos u takuar me pasqyrën
Rris mjekër e mustaqe

Për të mos u takuar me pasqyrën
Nuk i laj sytë në mëngjes

Për të mos u takuar me pasqyrën
Mbaj syze të errëta

Nuk i shoh dot me sy as vitrinat
Dhe gjithçka tjetër pasqyruese e urrej

Por kjo ikje qyqare nga vetja
Nuk shërohet si një rrufë e lehtë

Për ta shikuar pa frikë veten drejt në sy
Duhet besuar Zotin e vërtetë

FLETËZDITARI
Sot ishte ditë me vapë qyteti
Si astmatik përpilitej asfalti
Çahej si pjepër unë shëtisja
Me duar në xhepa
Me syza si të Rej Çarlsit në sy ime motër
Mërdhinte sot nga ethet në klinikë
Më tha shpirti i paska rrënjët thellë o vëlla
Shikimi i saj mjegulluar si xham
Nga hukama kobsjellëse
S’thoshte asgjë më pak se vdekja

ABSURDI I ARTIT
Holi i stacionit
Mezi e ruan drejpeshimin
Nga braktisja e së dielës

Një vajzë me njërin sy të ënjtur
Me valixhe nën gjunjë me orë të ndalur
Lexon Kamynë
Në një ngjizje indiference e trishtimi

Pastruesja ma vërtit fshesën pranë këmbëve
Me cigare në gojë me jargë që i lëvaren
Si ngjyrë në një pikturë të qullët

Kush i beson absurdit të artit
Pshtë dashur të bëj çmos
Ta pres autobusin këtë të diel
Dhe syrin e ënjtur të kësaj vajze
Ta lexoj si metaforë

I KAM 500 VJET?

O Ajvaz, më duket si i kam 500 vjet, isha duke i thënë në ëndërr dhe po i mbaja nofullat me dorë, sepse më dukej se po më deformoheshin nga një ngashërim i nëndheshëm, kur Teuta më solli telefonin dhe u përpoq të më tregonte se po më kërkonte Ibrahim Berisha. Vajza e Agronit ende po luante me dhe në oborrin e shtëpisë së vjetër, mu aty ku ishte një gardh i lartë dikur. Disa hapa larg kotecit dhe një vije me ujë të ndotur. Unë po e shikoja me habi, ndërsa me Ibrahimin po merreshim vesh të takoheshim në ëmbëltoren Mimoza.

Ndoshta vërtet i kam 500 vjet. Kjo matje e kohës, si e bëjmë ne, s'është e thënë të jetë e saktë, mësa është e saktë ajo vijë që ne mendojmë se e ndan realitetin nga ëndrra dhe jetën nga vdekja.

SHUMËZIMI I VDEKJES
Nesër do të vdes sërish
Në të njëjtën mënyrë
Në të njëjtin çast
Kur dielli si lafshë gjeli e përgjakur
Do të përpilitet pa shpresë
Ndërmjet kodrës e detit në Tivar
Sytë do të më ngurosen
Si mbishkrime tibetiane në gur
Dhe asgjë s'do të ndryshojë
Në itineraret e ditëve
Frika sërish do të afrohet tinëzisht
Si krokodili nëpër ujë të turbullt
Përfytyrimeve të mia
Deri në një çast të vërtetë

“OJ SHQIPNI MOS THUEJ MBAROVA”
Në ora shtatë të mëngjesit
Mbështetur për një trung bliri
Si statujë e përdhunuar
Përballë platosë së autobusëve
Rri e vështroj

Ata nisen me radhë në kohë të caktuar
Për në Malme për në Oslo
Për në Helsinki
Të mbushur spic gra e fëmijë
Që nën ritmet e këngës
Oj Shqipni mos thuej mbarova
Përshëndesin me lot në sy
Derisa rrotat e autobusëve si gurë mulliri
Bëjnë rrotullimet e para
Si gurët që bluajnë kokrra gruri

Statujës i ther në shpirt
Kjo ikje e përjetshme
E shndërruar në humnerë
Nëpër mijëvjeçarë
Po kjo këngë në ikje
Ngjizur me lot e me harrim ç’duhet
Farsë e të qenit shqiptar

KUR QENI CIATË
Këtë mëngjes edhe Agimi
Ia ktheu shpinën shtëpisë

Kthesa e fundit e përbiu
Si akulli që çahet papritur

Nëpër oborrin e shtëpisë
Ende enden hije
Babai nëna dhe motra
Si aktorë në një dramë
Po hapat e tyre s’ndihen
Ata shkelin mbi plagë

Vetëm qeni i lidhur në stelë
Ciatë ciatë ciatë
Me putra gërvish dheun
E sikur thotë
Ç’arsye kam më shumë unë
Ta ruaj atdheun

PRAPA MBETET ZBRAZTËSIRA
Si një shtjellë para sysh
Po më shpërbëhet atdheu

Fëmijë që s’kuptojnë ku i shpiejnë
Tek i veshin me ngut
Gra anemike
Që duan të ikin kudoqoftë
Nga vetja
Dhe burra zëçjerrë
Që dridhen si fotografia në ekran
Kur antenat i dridh stuhia

Si një shtjellë para sysh
Po më shpërbëhet shpirti

Prapa mbetet zbraztësira
Në formë përfytyrimi për pishën
Që kur përplaset ah kur përplaset
Bën një përpjekje të ngrihet
Dhe ashtu e bën absolut
Kuptimin për vdekjen

TERAPI ME QUKAPIKË
Ishte një ëndërr me shumë qukapikë
Që çukisnin tak tak tak
Nëpër trungjet e ajrit të rralluar

Njëri bënte ç'bënte e më çukiste në ballë
Tak tak tak miqësisht
Është ora ta pish një tabletë Histazol
Tak tak tak në tru si mbi dru
Në dhe të huaj

DIMËR NË ZEMËR
Një nënë e shikon diellin
Në të perënduar
Se nga ç’zonë e zemrës
Dhembja si ngjyrë i derdhet
Në formë të së folmes përçart
Ku je në këtë çast humneror
O bir nëna të pastë

Në oborr hije dhe mungesë
Si një dalmatikë dridhen
Ndërsa larg në hapësirë
Një plym kojrilash
Paralajmërojnë dimrin e gjatë

O Zot
Ç’parathonë këto shigjeta kojrilash
Për Lanskrunën e largët

DALJA E ATDHEUT EDHE NGA ËNDRRAT
Më parë kjo ishte vatër
Ku shtrohej tryeza e kënga
Ku rriteshin fëmijë
Thureshin ëndrra

Një Fitore një Ilir një Shpresë
Dhe një Atdhe i vogël

Ata janë tash diku në Kirunë
Janë bërë më të brishtë
Më apatikë
Dhe në ëndrra u futen me përdhunë
Shkretëtira të bardha

Atdheun s'ua kujton asgjë më
Madje as këtë vatër
Me themele që mbahen
Mbi emrat e tyre ndër shekuj

FËMIJA I XHAMTË
Unë lëviz dorën
Ai dorën

Unë shtrëngoj nofullat
Ai nofullat

O zot
Paskësh qenë fëmijë i xhamtë

Po nënës përse i dhimbset
Kaq shumë

NJË PARALAJMËRIM
Mbi një copëndërr
Nga shpalosej humnera
Në një hotel në Berlin
I kërrusur si pikëpyetje
E krijuar nga gërryerjet në shkëmb
M’u shfaq i pikëlluar

Po më shfytyron braktisja
Ikja jote po më thërrmon
Si dora barbare një statujë

Dhoma dhe reproduksionet në mure
Ishin në komë të thellë
Vetëm perdet tundeshin
Si kur përvidhet nëpër to dikush
Që të jep një paralajmërim

PROFIL
Gjumin ia prishin ëndrra surealiste
Gazi lotësjellës i figurave ia zë frymën
Në udhëkryq e vonojnë njësitë tankiste
Ku bashkë me urrejtjen përbin pështymën

Në qoshkun e parë blen një krah gazeta
Gazeta me germa e me gjuhë të huaj
Dante Aligierit s'i bëri gjë Mesjeta
Kohë dhe më barbare tha vijnë në shekujt tuaj

Si mbi qelqe të thyera shkel nëpër asfalt
I molepsur droje dhe përfytyrimesh
Përmbi kokë ka retë si kërminj gjigantë
E në zemër fshehur një tumë frymëzimesh

Vdes nëse s'e vrasin për fjalët e veta
Dhe i përgjunjet përjetë një gjumi guror
Në kujtesë të turbullt kombi i balsamohet jeta
Lulja e shpëtimit mbi varr a i rri kurorë

Shënime autobiografike

I. Shkollimi:

Milazim Krasniqi u lind më 25 tetor 1955 në Breznicë, një lokalitet afër Prishtinës.
Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të mjekësisë në Prishtinë.
Studimet për letërsi shqipe i kreu në Universitetin e Prishtinës, ku magjistroi në vitin 1988, me temën "Struktura e vargut të Ndre Mjedjes". Po në Universitetin e Prishtinës, ka fituar gradën e doktorit të shkencave filologjike me tezën e disertacionit "Soneti në poezinë shqipe" më 15 shtator 2004.

II. Botimet:

Poezi

1982 - Imazhi gri
1885- Pirg vegimi
1987- Qeshje sardonike
1990- Formula e Katonit
1994- Kurs për pantomimë
1996- Dalja e atdheut edhe nga ëndrrat

Prozë (romane)
1998- Fijet e shpirtit
2002- Fotografitë e kujtimeve

Dramaturgji

1990- Zbulimi,
Mos më merrni në qafë,
Punë Sizifi
1996- Kur lindi partia,
1997- Kush i bie fyellit
2001- Bryma e vdekjes
Kosovë në ndërgjegje
2003- Monedha e Gentit
2004 Rulet rus për Ali Pashën
2004 1999 Tragjedi shqiptare (trilogji)
Bryma e vdekjes(botim i dytë)
Një Antigonë e re
Kësulkuqja e shekujve

Publicistikë
1998- Horrat në krye të detyrës
2000- Kosova pas 22 janarit 1998

III. Angazhimi profesional dhe publik

1975-1980: teknik medicinal në Klinikën e Kirurgjisë të Fakultetit të Mjekësisë në Prishtinë,
1981-1986: përkthyes po në këtë klinikë,
1987-1990: redaktor i revistës për kulturë “Fjala”,
1988-1999: sekretar i Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës,
1990-1995: kryeredaktor i revistës “Fjala”,
1995-1999: redaktor përgjegjës për Kosovë i gazetës ditore “Bota Sot”, 1999-2000: kolumnist i gazetës “Kosova Sot” dhe “Gazeta e Re”,

2001: kryeredaktor i revistës “Interesi Nacional”,
2001-2004: anëtar i Bordit të Drejtorëve të Radiotelevizionit të Kosovës dhe analist te Radio Europa e Lirë,
2003-2004: bashkëpunëtor për lëndën Sociologjia e letërsisë në Fakultetin e Filologjisë në Prishtinë.

Në vitet 1989-2001 ka qenë i angazhuar edhe në politikë, po nga marsi i atij viti, është tërhequr tërësisht nga jeta politike.

Jeton në Prishtinë.